



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIA PRAVEDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	550
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	02	Data Datum Date	17.07.2025
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Këshilli Drejtues / Upravni Odbor/ Steering Committee

Nr. 01/ **550**/2025

Datë: 16/07/2025

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në bazë të nenit 10 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe nenit 25 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, nenit 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 i Rregullores nr. 02/2023 për plotësim ndryshimin e Rregullores nr. 02/207 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë dhe nenit 41 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më datë 16 korrik 2025 merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr. 269/2025 i datës 11 korrik 2025 për plotësim ndryshimin e vendimit për propozimin e mentorëve për gjyqtarët me mandat fillestar.
2. Plotësohet dhe ndryshohet vendimi i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë nr. 01/238/2025 i dt. 29.01.2025 me të cilin caktohen mentorët për gjyqtarët e sapoemëruar (gjenerata XII) si në vijim:
 - 2.1 Për Gjykatën Themelore Gjakovë, në vend të Gjyqtarit z. Durim Balaj caktohet si mentorë gjyqtarja znj. Fëllënza Knushaj;
 - 2.2 Për Gjykatën Themelore Mitrovicë, në vend të Gjyqtarëve z. Avdullah Mecinaj dhe z. Hajrullah Aruqi caktohen si mentor gjyqtarët z. Fuad Haliti dhe z. Genc Hasani.
3. Obligohen mentorët t'i përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Arsyetim

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me vendimin nr. 22/2025 të datës 24 janar 2025 i ka propozuar për emërim Akademisë së Drejtësisë listën e mentorëve për gjyqtarët me mandat fillestar (gjenerata XII).

Këshilli Drejtues i AD-së, listën e propozuar të mentorëve e ka miratuar në takimin e zhvilluar më datë 29 janar 2025, pjesë e së cilës ishin edhe gjyqtarët z. Durim Balaj si mentor i caktuar në Gjykatën Themelore Gjakovë si dhe gjyqtarët z. Avdullah Mecinaj dhe z. Hajrullah Aruqi të caktuar si mentor në Gjykatën Themelore Mitrovicë.

Me rastin e transferimit të gjyqtarit Durim Balaj nga Gjykata Themelore Gjakovë në Gjykatën Themelore Prishtinë dhe pensionimin e gjyqtarëve Avdullah Mecinaj dhe Hajrullah Aruqi, Këshilli Gjyqësor i Kosovës në takimin e datës 11 korrik 2025 ka marr vendim për plotësim ndryshim të listës së mentorëve të propozuar, duke i zëvendësuar si në pikën 2 të dispozitivit.

Ky plotësim ndryshim i vendimit është bërë për të siguruar vazhdimësinë e procesit të trajnimit praktik për gjyqtarët me mandat fillestar.

Fejzullah Rexhepi

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë



Vendimi i dërgohet:

- Drejtorit Ekzekutiv të AD-së
- Këshillit Gjyqësor të Kosovës
- Mentorëve të angazhuar
- Udhëheqëses së Divizionit në PTF
- Arkivit të Akademisë së Drejtësisë